

VENDIM
Nr.350, datë 12.5.2010

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË “JURIDIK”,
“SHKENCA KOMPJUTERIKE”, “SISTEMET E INFORMACIONIT” DHE
“TEKNOLOGJI INFORMACIONI”, NË UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR MOISIU”,
DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Hapjen, në universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, e programeve të studimit të ciklit të parë “Juridik”, “Shkenca kompjuterike”, “Sistemet e informacionit” dhe “Teknologji informacioni”. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet, përkatësisht “Diplomë e Nivelit të Parë DNP, në drejtësi, “Diplomë e Nivelit të Parë, DNP, në shkenca kompjuterike”, “Diplomë e Nivelit të Parë, DNP, në sistemet e informacionit” dhe “Diplomë e Nivelit të Parë, DNP, në teknologji informacioni”.

2.Programet e studimit të ciklit të parë realizohen me 180 kredite, ECTS, dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 (tri) vite akademike.

3.Programet e studimit “Juridik”, “Shkenca kompjuterike”, “Sistemet e informacionit” dhe “Teknologji informacioni” të fillojnë veprimtarinë në vitin akademik 2010-2011.

4.Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, pa efekte buxhetore shtesë.

5.Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha